Prot 6113
28.06.19

ALBPETROL sh.a
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-v
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIM OSE HUMBJES DHE TË TE ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN NETO	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5– 30

AUDITUES LIGJORE

Vullnetare Çela	Arqile Mishtaku	Njazi Laze	Tatjana Filto	Sokol Toska
Rr. Komuna e Parisit, Komp. Kika 2, Kulla 4, kt. 4, Tirane	Lagja 28 Nentor, Pall. nr 455, Ap.3, Kat i2, Vlore	Lgj. Konf.e Pezes, Rr. Jakov Xoxa, P. Mert ri 1, Fier	Sheshi Willson, Kulla Fat j kat iVIII, Tirane	Rr.Tish Dahia, Komp. Kika 2, Kulla 2, Nr.33, Tiranë

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Drejtuesit dhe Aksionerin e ALBPETROL sh.a.

Opinion me rezerve

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë Albpetrol sha (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në "Bazat për Opinionin me rezerve", pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat per Opinionin me rezerve

1. Në shënimin 6 te pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018, "Aktivet Afatgjata Materiale" paraqiten me vlerën 34,864,090 mijë lekë (2017: 46,358,258 mijë lekë). Shoqeria ka paraqitur Aktivet Afatgjata Materiale me vleren e drejte mbeshtetur ne rivleresimin e kryer nga vleresues të pavarur sipas raportit te dates 20 shkurt 2017, i cili vlereson aktivet në datën 1 janar 2015. Megjithatë, riparaqitja e aktiveve me ketë vlere të drejte është kryer vetem në pasqyrat financiare të periudhës 2018. Në pajtim me standardin SNK 16 "Aktivet Afatgjata Materiale", riparaqitja duhet të kryhej që nga periudha 2015 në menyrë retrospektive. Për rrjedhojë më 31 dhjetor 2017 aktivet afatgjata materiale janë të mbivlerësuara për 12,083,155 mijë lekë, rezervat e rivlerësimit janë të mbivlerësuara për 6,538,141 mijë lekë dhe fitimi i pashpërndarë është i mbivlerësuar për 6,206,927 mijë lekë. Gjithashtu, ne rastet kur shoqeria paraqet Aktivet Afatgjata me vleren e drejte me metoden e rivleresimit, për secilën kategori të rivlerësuar të aktiveve afatgjata materiale, ajo duhet te jape informacione ne shenimet shpjeguese per vlerën kontabël (neto) që do të ishte njohur sikur aktivet të mateshin pas njohjes duke përdorur modelin e kosto. Keto te dhena mungojne ne pasqyrat financiare te peridhes 2018.

2. Në shënimin 4 të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 Dhjetor 2018 inventari paraqitet në vlerën 2,589,561 mije lekë (2017: 2,978,209 mije lekë). Per shkak se ne u emëruam si auditues në datën 13 Dhjetor 2018, ne nuk ishim te pranishem në procesin e inventarizimeve vjetore te cilat shoqeria i kishte realizuar ne daten 30 Shtator 2018. Me gjithe procedurat e tjera të zbatuara, per shkak edhe te natyres se regjistrimeve te shoqerise, ne nuk mundëm të siguroheshim nëpërmjet evidencës së duhur dhe të mjaftueshme në lidhje me sasite e inventarit ne daten 31 Dhjetor 2018. Gjithashtu, në pajtim me parashikimet në SNK 2 "Inventarët", kur inventarët dëmtohen, janë bërë tërësisht ose pjesërisht të vjetruar ose nëse çmimet e shitjes së tyre kanë rënë, shoqeria duhet te kryeje zhvlerësimin e inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme. Shoqëria trashegon inventare te vjeter ne vleren 1,447,815 mije Lekë dhe ka njohur zhvleresime per inventaret ne vleren 137,487 mije Lekë në periudha të mëparëshme, megjithate, nuk eshte kryer nje test I vleres se inventarit dhe llogaritja e zhvleresimit ne daten e pasqyrave financiare me 31 Dhjetor 2018. Për këtë arsye, ne nuk mund të përcaktojmë efektet që mund të shkaktohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, si rrjedhoje e rregullimeve qe mund te jene te nevojshme te kryhen per inventaret.

3. Në shënimin 12, "Llogari të arkëtueshme të tjera", pasqyra e pozicionit financiar, paraqitet në vleren 3,493,244 mijë lekë (2017: 4,845,629 mijë lekë). Në kete vlerë perfshihen:

   a. Të drejta ndaj të tretëve për kontrata hidrokarbure, në vlerën neto 2,296,145 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 2,497,786 mijë lekë). Këto vlera përfaqësojnë vlerën neto përkatëse të sasisë së produktit, që është llogaritur sipas parashikimeve të kontratave hidrokarbure, por që nuk është lëvruar fizikisht në depozitat e Albpetrolit. Këto vlera në tërësi nuk konfirmohen si detyrim nga ana e kontraktoreve, janë të kontestuara ose janë kundershtuar në rrugë ligjore prej tyre. Shoqëria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

   b. Të drejta ndaj të tretëve për hua të dhëna me kontratë huaje sipas urdhërave të aksionarit në vlerën 446,070 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 316,071 mijë lekë). Për shkak se njesitë për të cilat janë dhënë huatë janë shoqëri të cilat i kanë pushuar aktivitetet, nuk shihen mundësi për arkëtimin e tyre dhe shoqeria nuk ka krijuar provizione lidhur me këto fakte dhe ngjarje ekonomike.

   c. Aktive të tjera mbi një vit në vlerën 624,074 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 dhe 1,323,389 mijë lekë në datën 31 dhjetor 2017. Ne nuk na u vunë në dispozicion informacione të mëtejshme lidhur me keto te drejta të arketueshme, per rrjedhoje, ne nuk ishim në gjendje të krijonim siguri të arsyeshme për ekzistencen dhe vlerën e paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të shoqërisë.

4. Në shënimin 11, "Llogari të arkëtueshme tregtare", në pasqyrën e pozicionit financiar, paraqitet shuma 15,948,387 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 16,232,706 mijë lekë). Për këto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave të letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Shoqëria nuk ka bërë teste zhvlerësimi dhe nuk ka llogaritur zhvlerësim për kërkesat e arkëtueshme, por ka paraqitur si zhvlerësim pergjithesisht llogaritë që

janë me nje vjetërsi mbi 5 vjet dhe që mundesitë e arketimit të ketyre llogarive jane konsideuar nga drejtimi si pa shprese. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektet që mund te rezultojne nga korrigjimet e mundshme të tyre, në pasqyrat financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2018.

5. Në shënimet 16 dhe 21 të pasqyrave financiare, gjendja e llogarive tregtare të pagueshme afatshkurtra paraqitet në vleren 8,863,618 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 8,803,693 mijë lekë). Per keto shuma ne nuk kemi mundur të arrijmë një siguri të mjaftueshme dhe të arsyeshme për saktësinë e tyre, as nëpërmjet procedurave te letrave të konfirmimit dhe as nëpërmjet kryerjes së procedurave alternative. Për rrjedhojë ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë ndonjë efekt që mund të rezultonte nga ndonjë korrigjim i mundshëm i tyre, në pasqyrat financiare te mbyllura më 31 dhjetor 2018.

6. Në shënimin 19, në pasqyren e pozicionit financiar, paraqiten "Detyrime të tjera", në vlerën 240,099 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 dhe 2017. Këto balanca shfaqen si kundervlerë e AAM, të cilat nuk disponohen më nga shoqëria apo jane jashtë perdorimit. Ne keto rrethana shoqeria duhe te zbatoje kerkesat e SNK 16 duke njohur këto vlera në pakësim të aktiveve afatgjata materiale dhe jo si detyrime. Për rrjedhojë Aktivet Afatgjata Materiale dhe Detyrimet e tjera janë të mbivlerësuara për 240,099 mijë lekë më 31 dhjetor 2018 (2017: 240,099 mijë lekë).

7. Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 12 "Tatimi mbi te ardhurat" kërkon që Shoqëria të njohë tatime të shtyra, për diferencat midis vlerës kontabël neto të aktiveve afatgjata materiale të rivlerësuara dhe bazës tatimore. Shoqëria nuk ka llogaritur tatimin e shtyrë. Për sa më sipër, ne nuk jemi në gjendje të vlerësojmë efektin që kjo përllogaritje do të kishte në pasqyrat financiare të Shoqërise në 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

8. Në shënimet për pasqyrat financiare Shoqëria nuk ka paraqitur shënimet për aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara në përputhje me SNK 37 si dhe shënimet për instrumentat financiare në përputhje me SNRF 7 së bashku me shënimet e menaxhimit të rrezikut.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i

gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërise është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi, duke dhënë informacione shpjeguese për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Organet e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport të audituesve që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen

në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

28 Qershor 2019

AUDITUESIT LIGJOR

Vullnetare Çela	Argile Mishtaku	Njazi Laze	Tatjana Filto	Sokol Toska

NJAZI LAZE
EKSPERT KONTABEL
I AUTORIZUAR

Audituesi Ligjor
SOKOL TOSKA
L62207031A
Tirana - Albania

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	6	34,864,090	46,358,258
Aktivet afatgjata jomateriale	7	134,283	44,821
Aktive biologjike	8	109	121
Totali i aktiveve afatgjata		**34,998,482**	**46,403,200**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	9	2,589,560	2,978,209
Shpenzime të shtyra	10	40,000	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	15,948,387	16,232,706
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	3,493,244	4,845,629
Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	13	1,475,142	249,413
Totali i aktiveve afatshkurtra		**23,546,333**	**24,305,957**
Totali i aktiveve		**58,544,815**	**70,709,157**
KAPITALI DHE DETYRIMET			
KAPITALI			
Kapitali themeltar		14,735,229	14,701,929
Prime te lidhura me kapitalin		0	(147,190)
Rezerva rivleresimi		36,377,046	43,062,377
Rezerva ligjore		538,769	538,769
Rezerva te tjera		909,719	909,719
Fitime të mbartura		(6,959,602)	(347,670)
Fitimi i ushtrimit		(19,973)	(405,005)
Totali i kapitalit	14	**45,581,188**	**58,312,929**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	15	128,082	141,321
Provizione afatgjata	16	80,000	30,000
Llogari të pagueshme tregtare	17		
Të tjera të pagueshme	18		
Detyrime të tjera	19	240,099	240,099
Grante dhe të ardhura të shtyra	20	65,330	68,373
Totali i detyrimeve afatgjata		**513,511**	**479,793**
Detyrime afatshkurtra			
Pjesa afatshkurtër e huasë afatgjatë	15	8,286	8,289
Llogari të pagueshme tregtare	21	8,863,618	8,803,693
Llogari të pagueshme të tjera	22	3,578,013	3,104,454
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**12,449,917**	**11,916,436**
Totali i detyrimeve		**12,963,627**	**12,396,228**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**58,544,815**	**70,709,157**

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga drejtimi i shoqërisë më 28 qershor 2018 dhe janë nënshkruar për publikim në emër të tyre nga:

ARIAN LAMÇAJ

Arian Lamçaj
DREJTOR I DREJTORISË SË FINANCES

Dritan Spahiu

Dritan Spahiu
ADMINISTRATOR

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjegruese ne faqet 5-30, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura operative			
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	23	6,375,144	6,676,765
Puna e kryer nga njesia dhe qe kapitalizohet	24	91,173	12,193
Të ardhura të tjera	25	44,042	213,994
Totali i të ardhurave operative		**6,510,359**	**6,902,952**
Shpenzime Operative			
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	26	(1,238,777)	(1,151,464)
Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proçes	27	(607,264)	(2,130,149)
Shpenzime personeli	28	(1,959,374)	(1,976,217)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	(620,846)	(312,197)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	29	(1,997,582)	(1,692,386)
Total shpenzime		**(6,423,843)**	**(7,262,413)**
Të ardhura/ Shpenzime financiare neto			
Të ardhura nga interest	30	324	171
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	30	(804)	(15,174)
Shpenzime të tjera financiare (neto)		9,836	-
Totali të ardhura/ Shpenzime financiare neto		**9,356**	**(15,003)**
Fitimi/humbja para tatimit		**95,872**	**(374,464)**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	31	(115,845)	(30,541)
Fitimi/humbja e vitit		**(19,973)**	**(405,005)**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		**(19,973)**	**(405,005)**

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të të Ardhurave Gjithpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 30, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto

	Kapitali i nënshkruar	Primi i lidhur me kapitalin	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi/ humbja e vitit	Totali
Më 1 janar 2017	14,701,929	-147,190	43,201,518	538,769	909,719	-1,880,101	1,532,431	58,857,075
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-	-	-	-	-			-
Zvogëlim i rezerves se rivleresimit	-	-	(139,141)	-	-	-	-	(139,141)
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	-	-	1,532,431	(1,532,431)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-	-	(405,005)	(405,005)
Më 31 dhjetor 2017	**14,701,929**	**(147,190)**	**43,062,377**	**538,769**	**909,719**	**(347,670)**	**(405,005)**	**58,312,929**
Më 1 janar 2018	14,701,929	(147,190)	43,062,377	538,769	909,719	(347,670)	(405,005)	58,312,929
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	33,300	-	-	-	-		-	33,300
Zvogëlim i rezerves se rivleresimit	-	147,190	(6,685,332)	-	-	(5,550,253)	-	(12,088,394)
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	-	-	(405,005)	405,005	-
Te tjera trasferime akt kontrolli						(656,674)		(656,674)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	-	-		(19,973)	(19,973)
Më 31 dhjetor 2018	**14,735,229**	**-**	**36,377,045**	**538,769**	**909,719**	**(6,959,602)**	**(19,973)**	**45,581,188**

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapitalin Neto duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 – 30, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		95,872	(374,464)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		620,846	312,197
Shpenzime për vlerën neto të AAM		3,533	77,091
Shpenzime provizion ceshtjesh gjyqesore		50,000	-
Shpenzime interesi		1,336	-
		771,587	**14,824**
Rregullime për ndryshimet në kapitalin punues:			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		1,465,516	(92,307)
Rënie/(rritje) në inventarë		388,649	1,170,023
Rënie/(rritje) në shpenzime të shtyra		(40,000)	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		60,125	(573,953)
Rritje/(rënie) në detyrime të pagueshme të tjera		332,164	17,887
Te ardhura te shtyra		(3,043)	(2,497,786)
		2,974,998	**(1,961,312)**
Tatimi mbi fitimin i paguar		196,738	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		**3,171,736**	**(1,961,312)**
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(1,195,274)	-
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		1,960	794,048
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata jomateriale		(97,442)	-
Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera		12	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		**(1,290,744)**	**794,048**
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		33,300	
Hua të paguara		(13,242)	
Rezerva rivlerësimi dhe akt kontrolli ndryshim ne Humbje te mbartura		(673,985)	1,393,291
Interes i paguar		(1,336)	(171)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		**(655,263)**	**1,393,120**
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		**1,225,729**	**226,856**
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të periudhës		**249,413**	**23,557**
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhës	15	**1,475,142**	**249,413**

Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 5 – 30, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Shënimet Shpjeguese

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albpetrol sh.a. ("Shoqëria") ka për objekt të veprimtarisë kryerjen e operacioneve hidrokarbure në përputhje me Ligjin Nr 7746, date 28.08.1993 për Kerkimin Zhvillim, Prodhimin, Trajtimin, Transportin, Magazinimin dhe Shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe çdo operacion tjetër tregtar apo shërbime që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë. Shoqeria brenda hapsirave të parashikuara nga legjilacioni në fuqi, do te kryejë çdo operacion projektues – preventivues, tregtar dhe financiar, qe lidhet drejteperdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarise dhe krijimin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit si dhe cdo aktivitet tjeter te mundshem e te ligjshem ne perputhje me interesat e saj. Realizimi i objektit te veprimtarise te shoqerise, do te behet nepermjet shfrytezimit dhe zhvillimit te zonave ekzistuese naftembajtese dhe ato gazmbajtese te vendit, kerkimeve te reja dhe zhvillimit te bloqeve ne administrim si dhe shfrytezimit te rerave bituminoze. Praktika atributet e ish APC-se Tirane, qe kane te bejne me kerkim – prodhimin e hidrokarbureve i kalojne shoqerise Alpetrol sh.a duke filluar nga data 01.04.2003.Furnizimin me energji elektrike te klienteve te kualifikuar. Tregtimin e energjise elektrike. Transmetimin e gazit natyror. Shperndarja e gazit natyror .Leje mjedisore per veprimtari me diktim ne mjedise per vendburimet e naftes ne zonat Kucove, Patos-Marinez (Drize +Goran), Ballsh Hekal, Amonice Gorisht, per vendburimet e gazit ne zonen Divjak – Lushnje, Frakull-Fier, Povelc Fier, Finiq –Sarand, rrjeti i transmetimit te produkteve te naftes dhe te gazit., vendburimi i reres bituminoze Kasnic-Fier, Uzina Mekanike Kucove dhe Uzina Mekanike Patos.

Shoqëria është themeluar në bazë të Vendimit të Gjykatës Nr. 21158 datë 8 Prill 1999 sipas regjistrit tregtar, bazuar në ligjin Nr. 7638, datë 19 Nëntor 1992 "Mbi shoqëritë tregtare". Selia e shoqërisë është ne adresën Patos, Fier.

Kapitali i nënshkruar i saj është 14,735,229,000 leke, i ndare ne 14,735,229 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili. Kapitali i paguar është regjistruar në Leke.

Aksionet e Shoqerise ALBPETROL Sh.a janë nën pronësinë e Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Drejtuesit e Shoqërisë jane si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Administratori i Shoqërisë

Këshilli Mbikëqyres i ALBPETROL sha ne date 31 dhjetor 2018 përbëhet si më poshtë:

1	Gledian	LLATJA	Kryeta
2	Koli	BELE	Anëtar
3	Stefanaq	KOCOLLARI	Anëtar
4	Andius	OLLDASHI	Anëtar
5	Enkelejda	PESHKEPIA	Anetar
6	Ilia	GJERMANI	Anetar

Administratori i shoqërisë: Kastriot Bejtaj

Me vendim numër 5, datë 05/03/2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sh.a., eshte liruar nga detyra e administratorit Z. Kastriot Bejtaj, dhe me vendim nr 6, date 05/03/2019, eshte emeruar ne detyren e administratorit te Shoqerise Albpetrol sh.a., Z. Dritan Spahiu.

Veprimtaria e përditshme e shoqërisë drejtohet nga Administratori, te cilit, i përkasin te gjitha kompetencat për drejtimin ekzekutiv dhe përfaqëson shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretet.

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2018 është 1.803 punonjës (2017: 2.277 punonjës).

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

Në përputhje me veprimtarinë dhe organizimin administrativ, shoqëria ka organizuar kontabilitetin në disa njësi vartëse ose qendra, te cilat përgatisin secila Pasqyra Financiare më vete dhe nxjerrin rezultat të veçantë. Në qendër, shoqëria përgatit Pasqyra Financiare përmbledhëse të bilanceve kontabël të njësive të saj. Kontabiliteti në Qendër është i informatizuar, ndërsa në njësitë vartëse mbahet në mënyre të përzier, manuale dhe të informatizuar.

Emërtimi i njësive vartëse është si më poshtë:

1-QPN Patos	(Qendra Prodhimit te Naftes Patos)
2-QPN Kucove	(Qendra Prodhimit te Naftes Kucove)
3-QPN Ballsh	(Qendra Prodhimit te Naftes Ballsh)
4-QASHNG	(Qendra Administrimit te Shitjes Nafte e Gaz)
5-QAKP	(Qendra Administrimit dhe Kontrollit te Prones)
6-QSHGJ	(Qendra e Sherbimeve Gjeofizike)
7-QFSHE	(Qendra e Furnizimit dhe Sherbimeve Elektrike)
8-QEMNG	(Qendra Emergjences ,Mjedisit,Naftes e Gazit
9-QFMT	(Qendra Furnizimit Materialeve Teknike)
10-QT Patos	(Qendra e Transportit)
11-QMN Kucove	(Qendra Mekanike Naftes Kucove)
12-QPN Gorisht	(Qendra Prodhimit Naftes Gorisht)
13-Administrata Albpetrol	

Me Vendim nr.604, date 22/12/2017 te Administratorit, si dhe me vendim nr.67, date 29/12/2017 te Keshillit Mbikqyres te Albpetrol sh.a., u vendos qe duke filluar nga data 1 prill 2018, Qendra e Prodhimit te Naftës Patos, nga nejsi vartese, kalon Sektor Prodhimi. Ne strukturen e organizimit te shoqerise, krijohet Qendra e Prodhimit te Naftes Fier e perbere nga 3 sektore: Prodhimit te Naftes Patos, Ballsh- Hekal dhe Cakran- Mollaj. Gjithashtu Qendra e Transportit Patos, bashkohet me Qendren e Furnizimit Materialeve Teknike, duke krijuar Qendren me emertim Qendra e Furnizimit dhe Transportit

Pavaresisht ketyre ndryshimeve strukturore te brendshme, per vitin 2018, informacionet, evidencat kontabel si dhe pasqyrat financiare u hartuan sipas struktures se meparshme, per te ruajtur vijimesine e celjes se pasqyrave financiare te vitit 2018.

Auditi i brendshëm

Ne shoqërinë Albpetrol sh.a. ekzistojnë procedura dhe programe qe synojnë te ndikojnë ne mbrojtjen e pasurise, ruajtjen e interesave te pronarit te vetem, zbulimin e anomalive dhe parregullsive, saktësimin e informacioneve ekonomiko-financiare, etj.

Për ndjekjen e kësaj pune vepron Departamenti i Auditit te Brendshem, i cili ka varësi te plote nga Keshilli Mbikqyres. Ky i fundit orienton, harton dhe miraton programet dhe planet e kontrollit për Departamentin e Auditit te Brendshem, i cili eshte pjese e kontrollit te përgjithshëm shtetëror dhe ushtron veprimtarinë e tij konform ligjeve, vendimeve te Keshillit te Ministrave dhe metodikave te hartuara nga strukturat e ngarkuara nga Keshilli i Ministrave për këtë qellim. Auditi i brendshëm nuk eshte ne përbërjen e strukturave te tjera te shoqërisë ALBPETROL SH.A.

Kështu gjate vitit 2018 Departamenti i Auditit te Brendshem ka kryer kontrolle te plota ekonomike dhe financiare sipas programit te hartuar dhe kane nxjerre rezultatet e tyre.

Bazuar ne strategjinë e zhvillimit te shoqërisë, prioritet i veçantë i është dhënë thithjes se investimeve te huaja.Gjate vitit 2018 ka vazhduar bashkëpunimi i shume kompanive te huaja me eksperience ne zhvillimin e vendburimeve te naftës dhe te gazit për kërkim-zbulimin e zhvillimin e vendburimeve qe administron Albpetroli,ne zbatim te Marrëveshjeve Hidrokarbure me kompanitë "Bankers Petroleum Albania" Ltd, " Anio Oil & Gas", "Sherwood" , dhe "Phoenix Petroleum", nga momenti i fillimit te marrëveshjeve dhe deri me 31.12.2018.

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

Tabela e mëposhtme jep numrin e puseve sipas çdo kompanie qe vepron ne baze te Marrëveshjes se Hidrokarbureve:

Nr	Emertimi i Shoqërisë	Nr i puseve të dorëzuar më 31 dhjetor 2017	Nr i puseve të dorëzuar në vitin 2018 Marrë shoqëritë	Marrë Albpetroli	Nr i puseve të dorëzuar më 31 dhjetor 2018
1	Bankers Petroleum	1143	11	0	1154
2	Anio Oil&Gas(ish Stream Oil&Gaz)	23	96	0	119
	b) Vendburimi BA-HE	23	96	0	119
3	Delvina Gaz	4	0	0	4
4	Sherwood	94	0	0	94
5	IEC Visoke	235	0	0	235
6	Phoenix Petroleum	490	0	363	127
	Gjithësej(1+2+3+4+5)	1985	107	363	1733

Emertimi i Shoqërisë	Data e dorëzimit në 2018	Aktiv	Jo aktiv	Marrë nga Albpetroli	Dorëzuar
Bankers Petroleum	10.07.2018	0	5	0	5
	07.09.2018	0	5	0	5
	21.09.2018	0	1	0	1
Anio Oil&Gas(ish Stream Oil&Gaz)	31.07.2018	96	0	0	96
a) Vendburimi Ballsh-Hekal	31.07.2018	96	0	0	96
Sherwood		0	0	0	0
Transoilgrup		0	0	0	0
Phoenix Petroleum		16	347	363	0
vb naft Drashovice	21.03.2018	1	68	69	
vb gaz Frakull	21.03.2018	4	29	33	
vb gaz Panaja	21.03.2018	1	0	1	
vb gaz Povelçë	21.03.2018	2	18	20	
vb gaz Ballaj-Kryevidh	21.03.2018	1	71	72	
vb gaz Divjakë	21.03.2018	7	161	168	
FIN-PEK Petroleum		0	0	0	
a)vb nafte Pekisht-Muriz		0	0	0	
b)vb gaz- kondesatFiniq-Krane		0	0	0	

Gjate vitit 2017, si rezultat i ndryshimit te marreveshjeve Hidrokarbure, jane marre nga kontraktori TransAtlantic Albania ltd, vendburimet Cakran-Mollaj dhe Gorisht-Kocul, si dhe nga kontraktori Phoenix Petroleum , vendburimi Amonice, vendburime, qe nga periudha e marrjes ne dorezim deri ne fund te vitit 2017, u administruan nga shoqeria Albpetrol sha, duke u perfshire ne treguesit e program zhvillimit te vitit 2017.

Ky fakt ndikoi edhe ne rritjen e disa zerave te shpenzimeve, ne ndryshim nga viti 2016.

Prodhimi i marre nga keto vendburime qe nga data e marrjes ne dorezim, eshte i reflektuar ne bilancet respektive te qendrave te shoqerise ku keto vendburime u bashkengjiten.

Datat e marrjes ne dorezim te vendburimeve paraqiten si me poshte:

1. **Marreveshja Hidrokarbure per vendburimin Gorisht-Kocul eshte mbyllur me date 25.01.2017.** Mbyllja e kesaj marreveshjeje u be bazuar ne shkresen e MEI me nr. 431/1 prot., date 24.01.2017, si dhe ne shkresen e Albpetrol sh.a,nr 7864 prot., date 02.12.2016, per ngritjen e grupit te punes per ndjekjen e procedurave te marrjes ne dorezim te vb. Gorisht-Kocul.

2. **Marreveshja Hidrokarbure per vendburimin Cakran-Mollaj eshte mbyllur me date 01.02.2017.** Mbyllja e kesaj marreveshje u be, bazuar ne shkresen e MEI me nr. 431/1 prot., date 24.01.2017, si dhe ne shkresen e Albpetrol sh.a, me nr. 7865 prot. date 02.12.2016, per ngritjen e grupit te punes per ndjekjen e procedurave te marrjes ne dorezim te vendburimit Cakran-Mollaj.

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

3. Marreveshja Hidrokarbure per vendburimin Amonice eshte mbyllur me date 13.03.2017.
Mbyllja e kesaj marreveshje u be, bazuar ne shkresen e MEI me nr. 936/4 prot., date 09.03.2017,si dhe ne shkresen e Albpetrol sh.a, me nr. 757/1 prot. date 10.03.2017, per ngritjen e grupit te punes per ndjekjen e procedurave te marrjes ne dorezim te vendburimit Amonice.

4. Marreveshja Hidrokarbure per vendburimin Ballsh-Hekal transferuar nga Transatlantic tek kompania Anio Oil&Gas sh.a.
Me daten 02.05.2018 pasi jane sekuestruar te drejtat e Marreveshjes Hidrokarbure nepermjet permbaruesit privat, eshte miratuar Instrumenti i Transferimit nga Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN).

5. **Vendburimet e gazit(Frakull,Panaja,Povelçë,Ballaj -Kryevidh dhe Divjakë) dhe vb Drashovicë në muajin Mars 2018 i kaluan Albpetrolit.**

2 Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-së.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Shumat janë paraqitur ne "000 Leke pervec rasteve ku citohet ndryshe.

2.5 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2 Bazat e përgatitjes (vazhdim)
2.5 Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)
2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe ne llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

3 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)
3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018
3.1.1 SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"

SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 "Të ardhurat", "SNK 11 Kontratat e ndërtimit", dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat. Standardi i ri krijon një model njohjeje me bazë kontrolli të ardhurave dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në mënyrë të detajuar nga SNRF-ve ekzistuese, duke përfshirë mënyrën për njohjen e marrëveshjeve me detyrime të shumta të performancës, çmime të ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të konsumatorit, opsionet e riblerjes, dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

Kontabilizimi i te ardhurave qe rezultojne nga kontratat me klientet behet duke perdorur nje model me pese hapa:

- Identifikimi i kontrates me nje klient
- Identifikimi i detyrimeve te performances ne kontrate
- Percaktimi i cmimit te transaksionit
- Shperndarja e cmimit te transaksionit ndaj detyrimeve te performances ne kontrate, dhe
- Njohja e te ardhurave kur njesia ekonomike permbush nje detyrim te performances

Sipas SNRF 15, parimi baze eshte qe nje njesi ekonomike do te njohe te ardhurat ne nje shume qe reflekton shumen ne te cilen njesia ekonomike pret te kete te drejten ne kembim te transferimit te sherbimeve per nje klient.

Ndryshimet kryesore nga praktika aktuale:

- Cdo mall apo sherbim i premtuar, i cili eshte i dallueshem, duhet te njihet me vete, dhe cdo zbritje mbi cmimin e kontrates, ne pergjithesi duhet te shperndahet mbi elementet e vecante.
- E ardhura mund te njihet me heret sesa sipas standarteve aktuale nese vleresimi ndryshon per ndonje arsye (sic mund te jene incentivat, ulje te tjera, tarifat e performances, honoraret, suksesi i nje rezultati etj.) shuma minimale duhet te njihet nese ato nuk perbejne nje risk te rendesishem kthimi.
- Momenti ne te cilen e ardhura eshte e mundur te njihet mund te zhvendoset: disa te ardhura te cilat aktualisht jane njohur ne momentin e perfundimit te kontrates, mund te duhen te njihen gjate kohezgjatjes se kontrates ose e kunderta.
- Ka rregulla specifike mbi licensat, garancite, tarifave fillestare te parimbursueshme dhe marreveshjet e ndermjetesimit, sa per te permendur disa.

SNRF 15 hyri në fuqi në periudhat raportuese vjetore që filluan më ose pas 1 janar 2018.

3 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 (vazhdim)

3.1.2 SNRF 9 "Instrumentet Financiare"

Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime të mëdha në udhëzimet e SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe prezanton një model të ri "humbje krediti të pritshme" për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

Gjatë adoptimit të SNRF 9, shoqëria ka aplikuar lehtësimin në tranzicion dhe ka vendosur të mos riparaqesë periudhat paraardhëse. Diferencat që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 në lidhje me klasifikimin, matjen dhe zhvlerësimin njihen në fitimet e pashpërndara.

SNRF 9 gjithashtu përmban kërkesa të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës. Kërkesat e reja kërkojnë të harmonizojnë më shumë kontabilitetin mbrojtës me aktivitetet e administrimit të rrezikut të njësive duke rritur mundësinë e depozitave të mbrojtura dhe instrumenteve mbrojtës dhe duke paraqitur një qasje më të bazuar në parime për të vlerësuar efektivitetin mbrojtës. Shoqëria zbaton kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës në mënyrë prospektive dhe të gjitha mbrojtjet kualifikohen për t'u konsideruar si marrëdhënie mbrojtëse të vazhdueshme.

Miratimi i SNRF 9 ka ndikuar fushat e mëposhtme:

- klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare të Shoqërisë. Drejtimi ka aktive financiare të mbajtura deri në maturim (HTM). Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogaritë e arkëtueshme të tjera e klasifikuara më parë si investime të mbajtura në maturim (HTM) sipas SNK 39 vazhdojnë të kontabilizohen me koston e amortizuar (AC) pasi ato plotësojnë detyrimet e mbajtura për të mbledhur sipas modelit të biznesit dhe testin e karakteristikave të flukseve monetare kontraktuale në SNRF 9.
- zhvlerësimi i aktiveve financiare duke zbatuar modelin e pritur të humbjes së kredisë. Kjo ndikon në llogaritë e arkëtueshme tregtare të shoqërisë dhe investimet në aktivet e tipit të borxhit të matura me koston e amortizuar.

Në datën e aplikimit fillestar, më 1 janar 2018, instrumentet financiare të shoqërisë për efektet e riklasifikimit analizohen si më poshtë:

Kategoria Aktiveve Financiare	SNK 39 Klasifikimi		Testi SPPI	Modeli i Biznesit	SNRF 9 Matja	Konkluzioni
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	Nuk u identifikua impakt financiar
Llogari të Arkëtueshme Tregtare	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	Nuk u identifikua impakt financiar
Llogari të Arkëtueshme Tregtare	HTM	AC	Priten të përmbushin kriteret e SPPI	Të mbajtuara për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale	AC	Nuk u identifikua impakt financiar

Shoqëria ka vendosur të mos riparaqesë informacionin krahasues në zbatimin fillestar të SNRF 9. Zbatimi i SNRF 9 dhe ndryshimi i politikës kontabël për ndikimin e bilancit fillestar të Shoqërisë më 1 janar 2018 paraqitet në tabelën në vijim. Në datën e aplikimit fillestar, më 1 janar 2018, instrumentet financiare të shoqërisë për efektet e matjes analizohen si më poshtë.

Aktivet	31 dhjetor 2017	Riparaqitje e balancave të çeljes	1 janar 2018
Mjete monetare	249,413	-	249,413
Llogari të arkëtueshme tregtare	16,232,706	-	16,232,706
Llogari të arkëtueshme të tjera	4,845,629	-	4,845,629
Total	**21,327,748**	**-**	**21,327,748**

Shoqëria zbaton një model të thjeshtëzuar të njohjes së humbjeve të pritshme të kredise, llogaritë e arkëtueshme tregtare të shoqërisë te tjera te arketushme të matura me koston e amortizuar dhe vlereson se nuk ka një ndikim të rëndësishëm finananciar në datën e aplikimit fillestar të standardit.

3 Aplikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

3.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

3.2.1 SNRF 16 "Qiratë"

SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse. Kjo kompleton projektin e gjatë e BSNK-së për të rishikuar të kontabilitetin e qirave. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një të drejte përdorimi të një aktivi dhe të një detyrimi qiraje.

SNRF 16 hyn në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin e plotë të Standardit dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të japë informacion sasior. Megjithatë, për të përcaktuar ndikimin Shoqëria është në proces të:

- kryerjes së një rishikimi të plotë të të gjitha marrëveshjeve dhe për të vlerësuar nëse ndonjë kontratë shtesë tani do të bëhet një qira sipas përkufizimit të ri SNRF 16
- përcaktimit të dispozitave kalimtare që do të miratojë; aplikimin e plotë retrospektiv ose aplikimin e pjesshëm retrospektiv (që do të thotë informacioni krahasues nuk duhet të riparaqitet). Aplikimi i metodës së pjesshme jep gjithashtu një opsion lehtësimi për rivlerësimin nëse kontratat ekzistuese janë, ose përmbajnë, një qira, si edhe lehtësime të tjera. Përcaktimi se cilët nga këto praktika do të miratohen është i rëndësishëm pasi ato janë zgjedhje të pakthyeshme
- vlerësimit të informacioneve shpjeguese të saj aktuale për qiratë financiare dhe qirave operative pasi këto kanë të ngjarë të formojnë bazën e shumave që do të kapitalizohen dhe të bëhen të drejta përdorimi të aseteve
- përcaktimin se cilat thjeshtëzime opsionale kontabël do të zbatohen për portofolin e tyre të qirasë dhe nëse se do të përdoren përjashtime
- vlerësimit të sistemit të IT dhe nëse nevojitet një sistem të ri leasing. Kjo është duke u konsideruar në përputhje me zbatimin e SNRF 15 dhe SNRF 9 në mënyrë që Shoqëria vetëm t'i nënshtrohet një sërë ndryshimesh të sistemit njëhkohësisht
- vlerësimit për dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë që do të nevojiten.

Shoqëria ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre.

Shoqëria planifikon të miratojë SNRF 16 më 1 janar 2019 duke përdorur metodën e aplikimit retrospektiv të modifikuar të Standardit. Sipas kësaj qasjeje, efekti kumulativ i zbatimit fillestar të SNRF 16 njihet si një rregullim në kapital në datën e aplikimit fillestar. Informacioni krahasues nuk riparaqitet.

Zgjedhja e kësaj qasjeje të tranzicionit rezulton në vendime të mëtejshme të politikave që shoqëria duhet të bëjë pasi ka disa lehtësime të tjera kalimtare që mund të aplikohen. Këto lidhen me ato qera të mbajtura më parë si qera të zakonshme dhe mund të aplikohen në bazë të analizimit të cdo kontratë. Shoqëria po vlerëson aktualisht ndikimin e zbatimit të këtyre lehtësimeve të tjera kalimtare.

4 Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja nga kurset e këmbimit për zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhë funksionale në fillim të vitit dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyera me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të nominuara në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj të cilat maten me kosto historike këmbehen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

4 Politikat Kontabël (vazhdim)

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Kurset e këmbimit zyrtare bankare të zbatuara sipas Bankës së Shqipërisë (Lekë kundrejt njësisë së monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR/Lek	123.42	132.95
USD/ Lek	107.82	111.10

4.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

4.2.1 Njohja dhe çrregjistrimi

Aktivet dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqeria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentit financiar.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga aktivi financiar, ose kur aktivet financiare transferohen dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet transferohen. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.

Një detyrim financiar çregjistrohet kur shuhet, shkarkohet, anulohet ose skadon.

4.2.2 Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Përveç atyre të arkëtueshme tregtare që nuk përmbajnë një përbërës të konsiderueshëm financimi dhe maten me çmimin e transaksionit në përputhje me SNRF 15, të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivet financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumenta mbrojtës, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Me kosto të amortizuar (AC)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Shoqëria aktualisht ka vetëm aktive financiare të klasifikuara me kosto të amortizuar

Klasifikimi përcaktohet nga:

- modeli i biznesit i njësisë ekonomike për menaxhimin e aktivit financiar
- karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivit financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare që njihen në fitim ose humbje paraqiten brenda shpenzimeve financiare, të ardhurave financiare ose zërave të tjerë financiarë, me përjashtim të shpenzimeve zhvlerësimit të të arkëtueshmet tregtare të cilat përfshihen brenda shpenzimeve të tjera.

4.2.3 Matja e mëpasshme e aktiveve financiare

i) Aktivet financiare me kosto të amortizuar

Aktivet financiare maten me koston e amortizuar nëse plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk janë paracaktuara si FVTPL):

- ato mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e mjeteve financiare dhe mbledhja e flukseve monetare kontraktuale
- kushtet kontraktuale të aktiveve financiare krijojnë flukse të mjeteve monetare që janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogaritë e arkëtueshmeve të tjera, që më parë ishin klasifikuar si të mbajtura deri në maturim sipas SNK 39, bëjnë pjesë në këtë kategori të instrumenteve financiare.

4.2.4 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 përdorin më shumë informacione të ardhshme për të njohur humbjet e pritshme të kreditit - 'modelin e humbjeve të pritshme të kreditit (ECL)'. Kjo zëvendëson SNK 39 'modelin e humbjeve të ndodhura'.

Instrumentet financiare në kuadër të kërkesave të reja përfshinin kreditë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit të matura me koston e amortizuar, llogaritë e arkëtueshme, aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, aktivet e kontraktuara të njohura dhe të matur sipas SNRF 15 dhe angazhimeve të huasë dhe disa kontratave të garancisë financiare (për emetuesin) që nuk maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Njohja e humbjeve të kreditit nuk varet me prej identifikimit të një ngjarje individuale të humbjes së kredisë mbi baze individuale. Në vend të kësaj, Shoqëria konsideron një gamë më të gjerë informacioni gjatë vlerësimit të rrezikut të kredisë dhe matjen e humbjeve të pritshme të kreditit, duke përfshirë ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale, parashikimet e arsyeshme dhe të mbështetura që ndikojnë në arkëtueshmërinë e pritshme të flukseve monetare të ardhshme të instrumentit.

Në zbatimin e kësaj qasjeje të ardhshme, bëhet një dallim midis:

- instrumentet financiare që nuk janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare ose që kanë rrezik të ulët të kredisë ('Faza 1') dhe
- instrumentet financiare që janë përkeqësuar dukshëm në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare dhe rreziku i kredisë i të cilit nuk është i ulët ('Faza 2').

'Faza 3' do të mbulonte aktivet financiare që kanë tregues objektive të zhvlerësimit në datën e raportimit.

Humbjet e pritshme të kreditit '12 - mujore' njihen për kategorinë e parë, ndërsa 'humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetës së instrumentit 'njihen për kategorinë e dytë.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë përcaktohet nga një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar.

Shoqëria nuk ka identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare me 31 dhjetor 2018.

i) Zhvlerësimi i mëparshëm i aktiveve financiare sipas SNK 39

Në vitin paraprak, zhvlerësimi i aktiveve financiare është bazuar në modelin e humbjeve të ndodhura. Aktivet financiare individualisht të rëndësishme testoheshin për zhvlerësim kur kishin tregues për rënie ne vlere. Aktvi financiare, të cilat nuk ishin individualisht të rëndësishme rishikoheshin për zhvlerësim në grupe të përcaktuara në bayë karakteristikav të rrezikut të kreditit të përbashkët. Shoqëria nuk kishte identifikuar dhe njohur zhvlerësim për aktivet financiare deri me 31 dhjetor 2017.

ii) Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Duke qenë se kontabilizimi i detyrimeve financiare mbetet kryesisht i njëjtë sipas SNRF 9 krahasuar me SNK 39, detyrimet financiare të Shoqërisë nuk janë ndikuar nga adoptimi i SNRF 9.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe, kur është e aplikueshme, përshtaten për kostot e transaksionit, përveç nëse Shoqëria ka përcaktuar një detyrim financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç derivativave dhe detyrimeve financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat mbahen më pas me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të cilat janë të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse).

Të gjitha pagesat lidhur me interesin dhe, nëse është e zbatueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje përfshihen në kostot financiare ose të ardhurat financiare.

4.2.5 Instrumentet financiare derivative dhe kontabiliteti mbrojtës

Shoqëria zbaton kërkesat e reja të kontabilitetit mbrojtës në SNRF 9 prospektivisht. Të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse që ishin marrëdhënie mbrojtëse sipas SNK 39 në datën e raportimit më 31 dhjetor 2017 plotësojnë kriteret e SNRF 9 për kontabilitetin mbrojtës më 1 janar 2018 dhe prandaj konsiderohen si marrëdhënie mbrojtëse të vazhdueshme.

Instrumentet financiare derivative llogariten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes (FVTPL) me përjashtim të derivateve të përcaktuara si instrumente mbrojtës në marrëdhëniet mbrojtëse të flukseve monetare, të cilat kërkojnë një trajtim të veçantë kontabël. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, marrëdhënia mbrojtëse duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

- Ekziston një marrëdhënie ekonomike midis zërit të mbrojtur dhe instrumentit mbrojtës
- Efekti i rrezikut të kredisë nuk dominon ndryshimet e vlerës që rezultojnë nga ajo ekonomike
- Raporti i mbrojtjes i marrëdhënies mbrojtëse është i njëjtë me atë që rezulton nga sasia e elementit të mbrojtur që njësia ekonomike aktualisht mbron dhe sasia e instrumentit mbrojtës që njësia ekonomike aktualisht përdor për të mbrojtur atë sasi të elementit të mbrojtur.

Të gjitha instrumentet financiare derivative të përdorura për kontabilitetin mbrojtës njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe raportohen më pas me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në masën që mbrojtja është efektive, ndryshimet në vlerën e drejtë të derivativëve të përcaktuar si instrumente mbrojtës në mbrojtjen e fluksit të mjeteve monetare njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe përfshihen në rezervën mbrojtëse të fluksit të mjeteve monetare në kapitalin neto. Çdo ineficense në marrëdhënien mbrojtëse njihet menjëherë në fitim ose humbje.

Në kohën kur elementi i mbrojtur ndikon në fitimin ose humbjen, çdo fitim ose humbje e njohur më parë në të ardhurat e tjera përmbledhëse riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe paraqitet si një riklasifikim brenda të ardhurave të tjera përmbledhëse. Megjithatë, nëse një aktiv ose detyrim jofinanciar është njohur si rezultat i transaksionit të mbrojtur, fitimet dhe humbjet e njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përfshihen në matjen fillestare të elementit të mbrojtur.

Nëse një transaksion i ardhshëm nuk pritet të ndodhë, çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse bartet menjëherë në fitim ose humbje. Nëse marrëdhënia mbrojtëse pushon të përmbushë kushtet e efektivitetit, kontabiliteti mbrojtës ndërpritet dhe fitimi ose humbja në fjalë mbahen në rezervën e kapitalit neto derisa të ndodhë transaksioni i ardhshëm.

Shoqëria nuk zotëron instrumenta financiarë derivative më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017.

4.3 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

4.4 Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

4.5 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

4.6 Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit efektiv.

4.7 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese.

Kostot e shndërrimit të inventarëve përfshijnë kostot e lidhura drejtpërdrejtë me njësitë e prodhimit, siç është puna e drejtpërdrejtë. Ato përfshijnë edhe një shpërndarje sistematike të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit fikse

dhe variabël të cilat kryhen gjatë shndërrimit të materialeve në produkte të gatshme. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit fikse janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat mbeten relativisht të pandryshueshme pavarësisht vëllimit të prodhimit, si për shembull, amortizimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave dhe pajisjeve të fabrikës dhe kostot e drejtimit e të administrimit të fabrikës.

Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit variabël janë ato kosto jo të drejtpërdrejta të prodhimit të cilat ndryshojnë në mënyrë të direkte, ose thuajse të direkte, me ndryshimin e vëllimit të prodhimit, si për shembull, materialet indirekte dhe puna indirekte.

Lendet e para	Me koston e blerjes dhe inventari i imët kosto blerje minus konsumin e llogaritur.
Prodhime ne proces	Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar
Produkt i gatshëm	Me kosto ne baze te metodës se mesatares se ponderuar

4.8 Aktive afatgjata materiale

i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale, paraqiten me vleren e rivlersuar, ne perputhje me rivleresimet e kryera gjate viteve: Në vitin 2005, bazuar ne vendimin e Ministrise se Ekonomise nr 4152 prot. date 12.07.2005, "Mbi rivleresimin e aseteve te shoqerive strategjike ", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave "Per autorizimin e shoqerive tregtare me kapital shteteror te sektorit strategjik, te rivleresojne pasurine", u krye rivleresimi i aseteve te kompanise Albpetrol sha. Gjithashtu, ne vitin 2009, ne zbatim te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr 1620, date 26.11.2008 "Per miratimin e emimeve te trojeve , qe ndodhen ne te gjitha bashkite e disa komuna", me shkrese nr 6616 prot. date 21.08.2009, te Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjitikes, u krye rivleresimi i zerit "Toka", ne grupin e AAM te Shoqerise Albpetrol sha.

Per gjendjen kontabel te aktiveve per vitin 2014, u krye rivleresimi i AAM, bazuar ne Urdherin e MZHETS, nr 1461 prot date 20/02/2015, "Per Rivleresimin e aseteve te shoqerise Albpetrol sha".

Bazuar ne raportin e rivleresimit te Aktiveve dhe testin e zhvleresimit të shoqerisë, sipas skemës kontabel që rrjedh nga procesi i rivleresimit, u kryen veprimet kontabel sipas tabelave përmbledhëse për çdo qendër të shoqerisë. Efektet financiare janë reflektuar në llogaritë financiare që prek ky proces për ushtrimin e vitit 2018.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor

Kostot përfshijnë shpenzime qe janë kryer drejtpërsëdrejti për blerjen e aktivit. Kostot e aktiveve te ndërtuara nga vete shoqëria, përfshijnë koston e materialeve dhe te fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër qe lidhet direkt me vënien e aktivit ne kushte pune, si dhe kostot e çmontimit te zhvendosjes dhe te magazinimit te tyre ne vendndodhjen përkatëse. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentë kryesor) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e një zëri të aktiveve afatgjata materiale vendosen duke krahasuar të ardhurat monetare nga shitja me vlerën e mbartur të aktiveve afatgjata materiale, dhe njihen neto brenda zërit "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kur aktivet e rivlerësuara shiten, sasitë e përfshira në rezervën së rivlerësimit transferohen në fitimin e mbajtur, ndërsa mungesa e rivlerësimit njihet ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimit te periudhës.

ii) Kosto të mëtejshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve me baze lineare për lidhjet teknologjike, puset e naftes, tubacione e rezervuar, mbi bazën e jetës se dobishme të vlerësuar të çdo pjese të një zëri të aktiveve

afatgjata materiale dhe me metodën zbritëse për ndertesat,makineritë dhe pajisjet, mjetet e transportit, pajisjet e zyrës dhe kompjuterike, dhe aktivet e tjera me një norme amortizimi siç shpjegohet me poshtë. Toka dhe punimet në proces nuk amortizohen.

AAM janë njohur ne kontabilitet me koston e blerjes se tyre dhe shoqëria ka zgjedhur si politike te saj kontabël modelin e kostos ku çdo element i AAM paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar. Shoqëria nuk ka akumuluar as një humbje nga zhvlerësimi. Deri ne vitin 2017, normat e amortizimit te zbatuara ishin ato te përcaktuara ne vendimin nr.24,dt.30/04/2007 te Këshillit Mbikëqyrës te shoqerise. Per periudhen ushtrimore te vitit 2018,shoqeria aplikoi norma te reja te amortizimit te miratuara nga Keshilli Mbikqyres me vendim nr. 4, date 11/04/2018, ne perputhje me normat fiskale te percaktuara ne ligjin nr.8438,dt.28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat".

Norma e amortizimit vjetor është si me poshtë:

	2018	2017
Baze lineare		
Ndërtesa		1.5%
Lidhjet teknologjike, puset, tubacione	1.5%	1.5%
Metoda zbritëse		
Makineri dhe pajisje	20%	2.5%
Pajisje informatike e të tjera	25%	3%
Ndertesa	5%	

iv) Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4.9 Aktive afatgjata jomateriale

i) Njohja dhe matja

Licencat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga Shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi, nëse ka.

ii) Shpenzimet e mëpassshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike për aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim/humbje kur ndodhin.

iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse duke përdorur metoden lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve jomateriale që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

4.10 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.

Të ardhurat nga shitja e naftës dhe gazit janë matur me vlerën e drejtë të pagesave të arkëtuara ose të arkëtueshme, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet dhe mbi fitimin (akcizat, taksat e rrugës, dhe të tjera të ngjashme). Te ardhurat nga shitja e mallrave janë matur me vlerën e drejte te pagesave te arkëtuara ose për tu arkëtuar, pakësuar me tatimet dhe taksat mbi shitjet. Të ardhurat nga shitja jane vleresuar me vleren e drejte te kompesimit te marre, neto nga kthimet, uljet tregtare, uljet mbi volumet dhe rabatet. E ardhura eshte njohur kur rreziqet dhe te drejtat mbi produktet i kalojne ne nje pjese te rendesishme bleresit, marrja e konpesimit eshte e mundshme, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme te mallrave mund te maten me besueshmeri dhe nuk ka me perfshirje te vazhdueshme te drejtimit te Shoqerise me keto produkte.

4.11 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.12 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shpenzimet e lindura nga qiratë operative njihen ne pasqyrën e te ardhurave ne baze te metodës lineare sipas kohëzgjatjes se qirasë.

Shoqëria ka qira operative.

4.13 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.14 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 është 15% (2017: 15%).

Tatimi i shtyre llogaritet duke përdorur metodën e bilancit kontabël, duke sjelle diferenca te përkohshme midis vlerës kontabël te aktiveve dhe pasiveve për raportin financiar dhe vlerës kontabël për qëllime tatimi. Diferencat e përkohshme nuk parashikohen për njohjen fillestare te aktiveve dhe pasive qe nuk kane asnjë ndikim mbi kontabilitetin apo fitimin e tatueshëm. Shuma e tatimit te shtyre bazohet ne mënyrën e pritshme te realizimit apo shlyerjes se shumes se akumuluar te aktiveve dhe pasiveve, duke përdorur normat tatimore ne fuqi ne datën e bilancit.

Një aktiv i detyrimit te shtyre njihet vetëm nëse ka te ngjare qe fitimet e ardhshme te tatueshme do te jene ne dispozicion, e ndaj te cilave aktivi mund te përdoret. Aktivet e tatimit te shtyre reduktohen deri ne shkallen ku nuk është me e mundur qe te realizohet përfitimi përkatës nga tatimi.

4.15 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.16 Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose te tërthortë) si rezultat i një ngjarje ne te kaluarën dhe ka mundësi qe do te nevojitet një fluks burimesh qe përfshin përfitimet ekonomike për te përmbushur detyrimin dhe ne këtë mënyrë mund te behet një përllogaritje e besueshme e shumes se detyrimit. Ne rast se efekti është material, provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme te parasë me normën e uljes para tatimeve, e cila reflekton vlerën kohore te parasë ne kushtet aktuale te tregut dhe, aty ku është e përshtatshme, normën e riskut te pasiveve specifike. Provizionet rishikohen ne çdo date bilanci dhe nëse nuk ka me mundësi për

nevojen e një fluksi burimesh qe përfshin përfitimet ekonomike për shlyerjen e detyrimit, provizionet kthehen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin qe janë njohur fillimisht. Ato nuk njihen për humbjet e ardhshme operative. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen.

4.17 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.18 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.19 Krahasueshmeria e informacionit kontabël

